



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

**OPINION I AVOKATIT TË POPULLIT LIDHUR ME KËRKESAT PËR LIRIM TË  
TË BURGOSURVE TË KATEGORIVE TË CAKTUARA NË KOHË PANDEMIE  
GLOBALE COVID-19**

**Për:** Znj. Albulena Haxhiu, ministre  
Ministria e Drejtësisë

Z. Arben Vitia, ministër  
Ministria e Shëndetësisë

Z. Nehat Thaqi, drejtor i përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, drejtor  
Departamenti i Shëndetësisë në Burgje

**Kopje për:** Z. Rasim Demiri, kryetar  
Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona  
të Pagjetur dhe Peticione

Z. Skënder Çoqaj, kryesues  
Këshilli Gjyqësorë i Kosovës

**Prishtinë, 23 prill 2020**

# **OPINION I AVOKATIT TË POPULLIT LIDHUR ME KËRKESAT PËR LIRIM TË TË BURGOSURVE TË KATEGORIVE TË ÇAKTUARA NË KOHË PANDEMIE GLOBALE COVID-19**

Ky opinion bazohet në ankesat e disa të burgosurve, të cilat iu drejtuan Avokatit të Popullit duke kërkuar lirim të parakohshëm apo lirim me kusht duke u bazuar në gjendjen në vend pas paraqitjes së rasteve të infektimit me COVID-19, i cili nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) u shpall pandemi globale. OBSh-ja kërkoj nga qeveritë e shteteve që të marrin masa të ashpra për ta parandaluar COVID-19. Masa të tilla ndërmori edhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Shërbimi Korrektues i Kosovës ndërmori një varg masash sipas rekomandimeve të autoriteteve shëndetësore për ta parandaluar COVID-19 në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Këto masa përfshijnë ndalimin e vizitave për të burgosurit, ndalimin e transfereve, dërgimin e të burgosurve në seanca gjyqësore vetëm në raste të caktuara etj. Po ashtu, masa të ndryshme mjekësore ndërmori edhe Departamenti Shëndetësor i Burgjeve.

## **Gjendja momentale në burgje dhe qendrat e paraburgimit**

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës i Avokatit të Popullit, pas paraqitjes së rasteve të para me COVID-19 dhe masave të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për parandalimin e tij, i ka pezulluar përkohësisht vizitat në burgje dhe në qendra të paraburgimit, bazuar në parimin e “mosshkaktimit të dëmit më të madh” të rekomanduar së fundi nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe Nën-komiteti i OKB-së për Parandalim të Torturës. Megjithatë, monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria ka vazhduar intensivisht përmes kontakteve me autoritetet dhe duke pranuar ankesa nga të burgosurit përmes telefonit dhe përmes mundësive të tjera të komunikimit.

Më 13 mars 2020, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve e njoftoi Avokatin e Popullit se ka përgatitur një plan operues për parandalim të COVID-19, i cili parasheh një sërë masash dhe i cili iu dërgua të gjitha njësisve shëndetësore në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Deri më tani nuk u raportua asnjë rast i infektimit të të burgosurve me COVID-19. Pati raste të infektimit me COVID-19 nga radhët e zyrtarëve korrektues dhe të personelit mjekësor në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë. Në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShP) u ndërmorën masat e nevojshme për testimin e zyrtarëve dhe të të burgosurve, zyrtarët të cilët rezultuan pozitiv u dërguan në karantinë dhe në vetë izolim. IKShP-ja testoi një numër të të burgosurve të cilët rezultuan negativ. Deri më tani autoritetet relevante përmes shkresave zyrtare e njoftuan Avokatin e Popullit se janë duke e menaxhuar situatën pa ndonjë problem të veçantë.

## **Deklarata e Parimeve e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT) dhe Këshillat e Nën-komitetit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të burgosurve në kohën e COVID-19**

Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës është mekanizëm i Këshillit të Evropës, i cili monitoron zbatimin e Konventës Evropiane kundër Torturës në vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Ky mekanizëm, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar me UNMIK-un dhe me NATO-n, në vitin 2004 dhe në 2006, vizitoi edhe Republikën e Kosovës, vlerëson respektimin e të drejtave të të burgosurve dhe autoriteteve kompetente u jep rekomandime

për të përmirësuar trajtimin e të burgosurve në pajtim me standardet ndërkombëtare.<sup>1</sup> KPT-ja, deri më tani tri herë e vizitoi Kosovën dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës ia dorëzoi raportin e gjetjeve përmes UNMIK-ut. Pas dërgimit të raportit me gjetje dhe me rekomandime, nga Qeveria e Republikës së Kosovës kërkohet përgjigje për secilin çështje dhe për secilin rekomandim.

Më 20 mars 2020, KPT-ja publikoi Deklaratën e Parimeve për trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë globale COVID-19.<sup>2</sup> Me rastin e publikimit të këtyre parimeve, KPT-ja, ndër të tjera, thekson: *“KPT-ja, këtë Deklaratë ua dërgoi të gjitha vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, duke kërkuara nga ata që këtë Deklaratë tua dërgojnë të gjitha ministrive relevante, si dhe çdo autoriteti tjetër (përfshirë Gjyqësorin dhe Parlamentin) përgjegjës për gjendjen e personave të privuar nga liria e tyre. Në këtë letër, KPT-ja, u kërkon autoriteteve që deri më datë 30 prill 2020 t’ia dërgojnë këtij organi një raport të masave konkrete të ndërmarra nga autoritetet relevante në kontekst të pandemisë koronavirus (COVID-19) në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre në burgje, si dhe në institucionet tjera, në veçanti, në institucionet e kujdesit shëndetësorë dhe mirëqenies sociale dhe në institucionet e mbajtjes për të huajt.”*<sup>3</sup> Avokati i Popullit nuk është në dijeni nëse Republika e Kosovës ka pranuar apo jo një letër të tillë siç thuhet në këtë kumtesë të KPT-së, duke pasur parasysh se Republika e Kosovës nuk është vend anëtar i Këshillit të Evropës.

Po ashtu, përmes kësaj Deklarate, KPT-ja thekson se paraqitja e sëmundjes COVID-19 për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës ka krijuar sfida të jashtëzakonshme, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. Më tej KPT-ja në Deklaratë thekson:

*“Duke njohur detyrimet e qarta për të ndërmarrë veprim të vendosur për të luftuar COVID-19, KPT-ja, duhet tua përkujtojë të gjithë akterëve natyrën absolute të ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzorë dhe degradues. Masat mbrojtëse asnjëherë nuk duhet të rezultojnë në trajtim çnjerëzorë dhe degradues të personave të privuar nga liria e tyre.”*

Deri më tani Avokati i Popullit, përmes linjave telefonike në dispozicion për personat e privuar nga liria e tyre, nuk ka marrë asnjë ankesë për trajtim çnjerëzor apo degradues. Të gjitha ankesat e pranuar deri më tani i referohen lirimimit të parakohshëm dhe lirimimit me kusht.

Avokati i Popullit vëren se në parimin nr. 5 të Deklaratës së Parimeve, KPT-ja shprehimisht thekson:

*“Ndërsa kontakti i ngushtë personal inkurajon përhapjen e virusit, duhet të bëhen përpjekje të bashkërenduara nga të gjitha autoritetet përkatëse që të përdorin alternativa për privimin e lirisë. Një qasje e tillë është e domosdoshme, në veçanti, në situata të mbipopullimit. Më tej, autoritetet duhet të përdorin më shumë alternativa për paraburgimin, uljen e dënimeve, lirimimin e parakohshëm dhe lirimimin me kusht (nën mbikëqyrje); rivlerësojë nevojën për të vazhduar vendosjen e pavullnetshme të pacientëve psikiatrik; shikarkimin ose lënien në*

<sup>1</sup> Për më shumë për vizitat, raportet dhe marrëveshjet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës me UNMIK-un dhe NATO-n shih në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo>

<sup>2</sup> KPT, Deklaratë e Parimeve në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e sëmundjes së virusit Corona: pandemisë (COVID-19), përkthimi në gjuhën shqipe në: <https://rm.coe.int/16809d569f>. Versioni në gjuhën angleze në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/covid-19-council-of-europe-anti-torture-committee-issues-statement-of-principles-relating-to-the-treatment-of-persons-deprived-of-their-liberty->.

<sup>3</sup> Po aty.

*kujdesin e komunitetit, kur është e përshtatshme, banorët e shtëpive të kujdesit shoqëror; dhe të përmbahen, në masën maksimale dhe të mundshme nga ndalimi i migrantëve.”*

Përmes këtij parimi, KPT-ja u bënë thirrje autoriteteve kompetente që të zbatojnë masa alternative ndaj privimit nga liria, sidomos në raste kur ato përballem me **mbipopullim**. Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha vendet e privimit nga liria gjatë vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020, Avokati i Popullit, përmes raporteve me rekomandime, ka theksuar se këto institucione nuk përballen me mbipopullim. Kurse sipas ShKK-së, që nga paraqitja e COVID-19 në Kosovë, numri i të burgosurve ka rënë.

### **Nënkomiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Parandalim të Torturës (SPT)**

Ky nënkomitet i OKB-së ka për mandat realizimin e vizitave në vendet nënshkruese të Protokollit Fakultativ të Konventës së OKB-së kundër Torturës. Qëllimi i vizitave është vlerësimi i trajtimit të personave të privuar nga liria në shtetet nënshkruese të protokollit të lartpërmendur. Më 25 mars 2020, Nënkomiteti i OKB-së miratoi dokumentin me titull: **“Këshillë e Nënkomitetit për Parandalim të Torturës për Shtetet Palë Nënshkruese dhe Mekanizmat Kombëtarë Parandalues në lidhje me pandeminë Koronavirus”**.<sup>4</sup>

Republika e Kosovës nuk është palë nënshkruese e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese dhe Protokollit Fakultativ të kësaj Konvente, meqenëse ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe me instrumentet ndërkombëtare garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këto marrëveshje dhe instrumentet ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Një ndër konventat e përfshira në këtë nen është edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Duke i njohur sfidat me të cilat po përballen autoritetet kompetente për ta menaxhuar situatën e krijuar me COVID-19, domosdoshmërinë e kufizimit të të drejtave dhe të lirive të caktuara, masat e ndërmarra në vendet e privimit të lirisë dhe jashtë tyre, ky komitet përcaktoi masat të cilat duhet të ndërmerren nga autoritetet në të gjitha vendet e privimit nga liria, përfshirë burgjet dhe qendrat e paraburgimit, institucionet e paraburgimit për të huajt, kafenetë e mbyllura për refugjatë, spitalet psikiatrike dhe institucionet e tjera shëndetësore.

Këto masa përfshihen në 20 pika të cilat janë:

- 1) Të bëhen vlerësime urgjente për t'i identifikuar individët brenda popullatës në burgje dhe në qendra të paraburgimit të cilët përballen me rrezikun më të madh dhe të bëhet vlerësimi i të gjitha grupeve të cënueshme.
- 2) Ta reduktojnë popullatën në burgje dhe në institucione të tjera kudo që një gjë e tillë është e mundur duke zbatuar skema të lirimit të përkohshëm dhe të parakohshëm të të burgosurve për të cilët është e sigurtë që të bëhet një gjë e tillë, duke marrë parasysh masat alternative ndaj burgimit të parapara me Rregullat e Tokios.

<sup>4</sup> Dokumenti i plotë gjendet në gjuhën angleze në:

<https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/OPCAT/AdviceStatePartiesCoronavirusPandemic2020.pdf>

- 3) Vëmendje e veçantë t'i kushtohet institucioneve të burgimit dhe të paraburgimit në të cilat tejkalohet kapaciteti zyrtar i akomodimit (ka mbipopullim) dhe ku kapaciteti zyrtar bazohet në metra katrorë për person dhe i cili nuk lejon distancim social në pajtim me udhëzuesit standard për tërë popullatën e burgjeve si tërësi.
- 4) Të rishqyrtohen të gjitha rastet e paraburgimit me qëllim të përcaktimit nëse masa e paraburgimit është strikt e domosdoshme në dritën e urgjencës publike shëndetësore dhe të zgjerojnë shqiptimin e masës së dorëzarisë në të gjitha rastet, përveç rasteve serioze.
- 5) Të shqyrtohet përdorimi i institucioneve për paraburgim të të huajve dhe kampeve të mbyllura të refugjatëve me qëllim që të reduktohet popullata në këto institucione në nivelin më të ulët të mundshëm.
- 6) Lirimi nga burgimi duhet t'i nënshtrohet vlerësimit me qëllim që të sigurohet se masat e duhura po zbatohen ndaj atyre që janë pozitiv ose janë veçanërisht të cenueshëm ndaj infektimit.
- 7) Të sigurohet që çdo kufizim ndaj regjimeve ekzistuese të jetë minimal, proporcional me natyrën e urgjencës shëndetësore dhe në pajtim me ligjin.
- 8) Të sigurohet që mekanizmat ekzistues për parashtrim të ankesave të jenë funksionalë dhe efektivë.
- 9) Të respektohet standardi minimal për dalje ditore në ajër të pastër duke pasur parasysh në të njëjtën kohë masat e domosdoshme për ta parandaluar dhe për ta trajtuar pandeminë.
- 10) Të sigurohet që të ketë hapësira dhe furnizime të mjaftueshme (të siguruara pa pagesë) për të gjithë personat të cilët mbesin në burgje dhe në qendra të paraburgimit me qëllim që të lejohet higjienë në të njëjtin nivel me popullatën në tërësi.
- 11) Aty ku vizitat janë ndaluar për arsye shëndetësore, të sigurohen mënyra të tjera të cilat u ofrojnë të burgosurve kontakte me familjet e tyre dhe kontakte me botën e jashtme, për shembull përmes telefonit, internetit/email, video-komunikimit dhe mjeteve të tjera elektronike të përshtatshme. Kontaktet e tilla duhet lehtësohen, të inkurajohen dhe të jenë të shpeshta dhe pa pagesë.
- 12) Anëtarëve të familjes dhe të afërmeve t'u mundësohet që t'u sjellin të burgosurve ushqim dhe furnizime të tjera, në pajtim me praktikat lokale dhe me respektim të duhur të masave mbrojtëse.
- 13) Të akomodohen ata të cilët përbëjnë rrezik të madh me pjesën e mbetur të popullatës së burgjeve duke respektuar plotësisht të drejtat e tyre.
- 14) Të parandalohet që izolimi shëndetësor të mos marrë formën e masës disiplinore të vetmisë, masa e izolimit shëndetësor duhet të bazohet në vlerësimin e pavarur mjekësor, të jetë proporcionale, i kufizuar në kohë dhe të jetë subjekt i garancive procedurale.
- 15) Të sigurohet kujdesi mjekësor për të burgosurit të cilët kanë nevojë dhe nëse është e nevojshme jashtë burgjeve dhe qendrave të paraburgimit kurdo që një gjë e tillë është e mundur.

- 16) Të sigurohet që garancitë themelore procedurale kundër keqtrajtimit (përfshirë të drejtën për këshillim të pavarur mjekësor, asistencë ligjore dhe të garantohet që palët e treta të njoftohen për burgimin) të mbeten në dispozicion dhe të jenë operuese pa marrë parasysh kufizimin e qasjes.
- 17) Të sigurojnë që të gjithë të burgosurit dhe personeli të marrin informata të besueshme, të përditësuara dhe të sakta lidhur me të gjitha masat që po ndërmerren, kohëzgjatjen e tyre dhe arsyen për ndërmarrjen e masave të tilla.
- 18) Të sigurohet se janë ndërmarrë masat e duhura për të mbrojtur shëndetin e personelit mjekësor dhe korrektues dhe që ata të jenë të pajisur në mënyrën e duhur dhe të jenë të përkrahur në kryerjen e punëve të tyre.
- 19) Të sigurohet qasja në shërbime psikologjike të duhura për të gjithë të burgosurit dhe për personelin e prekur nga këto masa.
- 20) Të sigurohet që rekomandimet e lartpërmendura, nëse është e aplikueshme, të merren parasysh në lidhje me pacientët të cilët janë pranuar pa vullnetin e tyre në spitale psikiatrike.

### **Lirimi me kusht nga Paneli për Lirim me Kusht dhe kompetencat e Avokatit të Popullit**

Ligji nr. 05/L-129-për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton përbërjen e Panelit për Lirim me Kusht (PLK). Sipas nenit 18, paragrafi 2, PLK-ja tani përbëhet si në vijim: një gjyqtar i Gjykatës Supreme, i deleguar nga kryetari i Gjykatës Supreme; një gjyqtar i Gjykatës së Apelit, i deleguar nga kryetari i Gjykatës së Apelit, dhe një gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i deleguar nga kryetari i Gjykatës Themelore. Me ndryshimet e lartpërmendura, PLK-ja tani ka një përbërje plotësisht gjyqësore. Avokati i Popullit nuk ka kompetenca ndaj vendimeve të gjykatave, përveç në raste të zvarritje të procedurës.<sup>5</sup> Po ashtu, Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e PLK-së shprehimisht përcakton se vendimet e PLK-së nuk mund të ankimohen.

### **Falja nga presidenti**

Falja nga presidenti nënkupton pushtetin e jashtëzakonshëm ekzekutiv të presidentit për t'i falur personat e dënuar për vepra penale, duke i liruar nga dënimi i përcaktuar nga gjykata.<sup>6</sup> Sipas Ligjit për Faljen, falja është e drejtë e presidentit që ka për qëllim përdorimin e një mjeti jo të rregullt e të rrallë për t'i shpërblyer sjelljet dhe karakteret e jashtëzakonshme ose t'i adresojë shqetësimet e jashtëzakonshme humanitare.<sup>7</sup> Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga të dënuarit lidhur me faljen nga presidenti. Po ashtu ka pranuar ankesa nga të dënuarat për shkak se asnjë e dënuar nuk ishte falur nga presidenti. Në vitin 2019, presidenti shpalli Dekretin 250/2019 me të cilin shpalli tre të burgosur. Në mesin e tyre nuk ishte asnjë e dënuar. Avokati i Popullit, duke njohur diskrecionin e plotë të presidentit për të vendosur lidhur me çështjen, megjithatë konsideron se me rastin e faljes, duhet të merren parasysh edhe parimet e barazisë gjinore dhe të mosdiskriminimit të parapara me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.

<sup>5</sup> Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16.8.

<sup>6</sup> Ligji nr. 03/L-101 për Faljen, neni 2.

<sup>7</sup> Ligji nr. 03/L-101 për Faljen, neni 3, paragrafi 1.

## **Pezullimi i përkohshëm i ekzekutimit të dënimit**

Ligji nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton si në vijim: *“Pezullimi i përkohshëm i ekzekutimit të ndonjë dënimi nënkupton çdo lirim të personit të dënuar nga objekti korrektues, gjatë të cilit nuk llogaritet koha e vuajtjes së dënimit me burgim.”* Më tej ky ligj përcakton se për këtë vendos kryetari i gjykatës themelore kompetente bazuar në kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Kundër vendimit të kryetarit të gjykatës themelore, sipas ligjit në fuqi, lejohet ankesë në Gjykatën e Apelit.<sup>8</sup>

## **Lirimi i parakohshëm**

Ligji nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenin 1, përcakton si në vijim: *“Me kërkesë të personit të dënuar, Gjykata kompetente mund ta lirojë personin e dënuar para përfundimit të mbajtjes së dënimit të tij me burgim nëse ai ka pasur sjellje të mirë, suksese në punë dhe në aktivitete të tjera.”* Bazuar në dispozitat e këtij neni, del se sërish është kompetente gjykata kompetente.<sup>9</sup>

## **KONKLUZION**

Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga disa të burgosur të cilët kanë kërkuar të lirohen nga vuajtja e mëtejme e dënimit duke iu referuar situatës së krijuar me paraqitjen e pandemisë globale COVID-19. Avokati i Popullit, në pajtim me Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe me legjislacionin relevant në fuqi, nuk ka kompetenca ndaj vendimeve të Panelit për Lirim me Kusht, e as ndaj vendimeve të gjykatave kompetente të cilat ndërlihen me lirimin e parakohshëm dhe pezullimin e përkohshëm të ekzekutimit të dënimit.

Duke njohur detyrimet e qarta për të ndërmarrë veprim të vendosur për të luftuar COVID-19, Avokati i Popullit ua rikujton të gjitha organeve kompetente të Republikës së Kosovës, të cilat janë përgjegjëse për personat e privuar nga liria, natyrën absolute të ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, e cila parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me legjislacionin relevant vendor, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Masat mbrojtëse asnjëherë nuk duhet të rezultojnë në trajtim çnjerëzor dhe degradues të personave të privuar nga liria e tyre. Çdo kufizim i të drejtave dhe i lirive themelore duhet të jetë i domosdoshëm, proporcional, me kohëzgjatje të caktuar, i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në ligj, si dhe në aktet juridike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të përfshira në Kushtetutë.

Po ashtu, autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës, në këtë periudhë, duhet të veprojnë në pajtim të plotë me Deklaratën e Parimeve të proklamuar nga KPT-ja më 20 mars 2015 dhe Këshillat e Nënkomitetit të OKB-së për Parandalim të Torturës për trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekst të luftimit të pandemisë COVID-19 të proklamuar më 25 mars 2020. Avokati i Popullit i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës që t'ua dërgojë të gjitha ministrive relevante, si dhe çdo autoriteti tjetër (përfshirë gjyqësorin dhe

<sup>8</sup> Ligji nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 94. Shih në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>.

<sup>9</sup> Ligji nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 127. Për më shumë shih në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>.

parlamentin) përgjegjës për gjendjen e personave të privuar nga liria e tyre, këto dy dokumente të rëndësishme të organizatave ndërkombëtare të lartpërmendura për trajtimin e personave të privuar nga liria në këtë periudhë pandemie globale.


Për më shumë, Avokati i Popullit inkurajon autoritetet kompetente që deri më 30 prill 2020 t'ia dërgojnë KPT-së një raport gjithëpërfshirës për masat konkrete të ndërmarra në kontekst të pandemisë globale (COVID-19) në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre në burgje, si dhe në institucionet e tjera, në veçanti në institucionet e kujdesit shëndetësor, të mirëqenies sociale dhe në institucionet e mbajtjes për të huajt.

Aty ku vizitat familjare janë ndaluar për arsye shëndetësore, të sigurohen mënyra të tjera të cilat u ofrojnë të burgosurve kontakte me familjet e tyre dhe kontakte me botën e jashtme, për shembull përmes telefonit, internetit/email, video-komunikimit dhe mjeteve të tjera elektronike të përshtatshme. Kontaktet e tilla duhet të lehtësohen, të inkurajohen, të jenë të shpeshta dhe pa pagesë.

Personave të privuar nga liria e tyre t'u garantohet niveli i kujdesit shëndetësor, i cili është në dispozicion për komunitetin e lirë. Autoritetet kompetente të ofrojnë kujdes mjekësor për të burgosurit edhe jashtë burgjeve dhe qendrave të paraburgimit nëse është e nevojshme, kurdo që një gjë e tillë është e mundur.

Avokati i Popullit inkurajon organet kompetente që të shqiptojnë sanksione alternative ndaj paraburgimit në mënyrë që të parandalohet rritja e numrit të të burgosurve dhe të mos rrezikohet parimi i mbajtjes së distancës sociale, e cila është një nga masat e proklamuar nga OBSH-ja në luftën kundër COVID-19.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,  
  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit